

VENDIM
Nr. 9/2017

PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT “PËR TË KONTROLLUAR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUQI DHE MBROJTJES SË INTERESIT TË SHQIPTAR NGA REALIZIMI I MARRËVESHJES PËR ZGJIDHJEN ME MIRËKUPTIM NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË “CEZ A.S.””, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 31/2016

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78, të Kushtetutës, të neneve 8, 9 dhe 13, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e komisionit hetimor,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit “Për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe mbrojtjes së interesit të shtetit shqiptar nga realizimi i marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “CEZ A.S.””, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 31/2016, zgjatet deri në datën 22 mars 2017.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 2.2.2017